



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË
INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 1283 prot.

Tiranë, më 04.02.2026

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1876/1, datë 22.11.2019.

SHOQËRISË “REALIZ” SH.P.K

Rr. “At Zef Pllumbi”, Katund i Ri, Lagja Valias, Objekti Nr. 36, Kashar, Tiranë

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “REALIZ” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1876/1, datë 22.11.2019, për mineralin traktolite, në Objektin “Fushë Lopë”, Bashkia Pukë, Qarku Pukë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 4324 prot., datë 10.11.2025, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 7821 Prot., datë 11.11.2025, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1876/1, datë 22.11.2019, për mineralin traktolite, në Objektin “Fushë Lopë”, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër, pasi në objekt nuk punohet dhe nuk ka filluar veprimtaria minerare në afatin e përcaktuar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “b” (ii) të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1876/1, datë 22.11.2019, për mineralin traktolite, në Objektin “Fushë Lopë”, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 “Procedura e revokimit të lejes”, keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1876/1, datë 22.11.2019, për mineralin traktolite, në Objektin “Fushë Lopë”, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën

2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin
minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME URDHËR PËR DELEGIM
ZËVENDËSMINISTRI
ERLIND SULO**

